



Prishtinë, 19 maj 2016
Kodi i ZRRE-së: V_808_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, Nenit 25, Nenit 29 dhe Nenit 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë; dhe
- Aplikacionin për licencim të aktivitetit të importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 25.11.2015 nga ndërmarrja "PAN INTERTRADE" SH.P.K. adresa: Afrim Logja, Lagjja Gjinaj, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në seancën e mbajtur me datë 19 maj 2016, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET** Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike ndërmarrjes "PAN INTERTRADE" SH.P.K., me numër licence ZRRE/Li_45/15 për periudhën nga data **19 maj 2016** deri **18 maj 2021**.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.07.2015 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike nga ndërmarrja "PAN INTERTRADE" SH.P.K.
- o ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave/dëshmive të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike.
- o Pas dorëzimit nga ndërmarrja në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmive të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.




- II. Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri **100 MW**, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "PAN INTERTRADE" SH.P.K.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe
- Departamentit Ligjor dhe të Licencimit-ZRRE


Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar